

FORMULARI I ANKESËS PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR DHE KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Ankesë drejtuar: Autoriteti/Entit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik

Seksioni I. Identifikimi i ankimuesit

Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (p.sh. individ, operator ekonomik, shoqatë, bashkim operatorësh ekonomikë)

InfoSoft Office

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

J62426002Q

NUIS/NIPT

Koder Kashar, Autostrada Tirane-Durres, Km 8

Adresa

Tiranë

Albania

1001

Qyteti

Shteti

Kodi Postar/Posta

0692036179

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

aarapi@infosoftoffice.al

E-mail

Administrator Frederik Prodani

Emri dhe titulli i zyrtarit të autorizuar për lëshimin e ankesës (ju lutemi shkruani)

Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar

2023/02/28

Data (viti/muaji/dita)

0692036179

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

Seksioni II: Informacion mbi procedurën

Numri i referencës së procedurës/Lotit

Plotësoni numrin e referencës së kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentin e tenderit.

REF-59766-02-21-2023

Tipi i procedurës për ankesën

Procedure Prokurimi Publik

Tipi i ankesës

Dokumenta Tenderi

Plotësoni llojin e procedurës së përdorur

Open Simple

Autoriteti/Enti Kontraktor

Emri i autoritetit/entit kontraktor që administron procesin e prokurimit.

Bashkia Prrenjas

Vlera e përlogaritur e prokurimit

Vlera e përlogaritur e kontratës/Marrëveshjes Kuadër (shuma në shifra dhe fjalë)

1299917

Objekti i kontratës/Marrëveshjes Kuadër

Përshkrimi i shkurtër i punëve/mallrave/shërbimeve objekt kontrate/marrëveshje kuadër.

Kancelari dhe shtypshkrime

Afati i fundit për paraqitjen e ofertës

Data (viti/muaji/dita)

2023/03/06

Data e publikimit të Njoftimit të Fituesit

(Data (viti/muaji/dita) nëse është e zbatueshme)

Data e nënshkrimit të kontratës

(Data (viti/muaji/dita) në rastet e kërkesave për pavlefshmërinë e kontratës)

Tipi i kontratës

Data e zhvillimit të procedurës

Mallra

2023/03/06

Numri i njoftimit

Kodi CPV

59766

30192124-630197220-430197643-544810000-

Ankese mbi argument në KPP

Seksioni III: Përshkrimi i ankesës

1. Baza ligjore

(Shkelje/arsyetime ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.)

Ligjin për Prokurimin Publik, nr. 162 dt. 23.12.2020, në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave.

2. Objekti i ankesës

- Modifikim i dokumentave të tenderit

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës tuaj.

(Citoni këtu arsyet e skualifikimit)

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të një/disa operatori/ëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

(Citoni operatorin/ët ekonomik për të cilin keni pretendime)

- Pavlefshmëri kontrate

(Citoni kontratën për të cilën kërkoni pavlefshmërinë)

- Tjetër

(Citoni këtu objektin e ankesës që nuk përfshihet më sipër)

3. Rrethanat dhe faktet □

Përshkruani rrethanat e faktit. □

Autoriteti Kontraktor, Bashkia Prrenjas, ka publikuar në faqen e APP-së në datë 22.02.2023, ora 1000, tenderin me objekt “Kancelari dhe shtypshkrime”, i cili parashikohet të zhvillohet me datë 06.03.2023, ora 1000.

Duke qenë se disa prej këtyre kërkesave i gjykojmë në shkelje të LPP, Rregullave të Prokurimit Publik, po paraqesim këtë ankesë.

4. Argumentime mbi shkeljet e pretenduara

Përshkruani në mënyrë koncize shkeljet e pretenduara, duke argumentuar qartë dhe saktë se përse pretendoni për paligjshmëri në veprimet e autoritetit/entit kontraktor.

1. Ne shtojcën 5 “specifikimet teknike”, në kolonën “specifikimi teknik” AK ka kërkuar:

Nr. EMËRTIMII MALLIT SPECIFIKIMI TEKNIK
E Certifikuar (Origjinale)

Se pari sa i perket shprehjes “E Certifikuar”:

Ky përcaktim “e certifikuar” nuk tregon një specifikim teknik. Nuk arrijme të kuptojmë se kujt i referohet AK me kerkese. Nga kush organ apo sipas kujt standarti duhet të jete i certifikuar produkti? Rekomandimi mbi hartimin e kriterëve për kualifikim për procedurat e prokurimit për punera mallra shërbime, datë 24.12.2021, pika 6 përcakton se:

“6. AK shpeshherë, përcaktojnë kriteret e kualifikimit, por pa përcaktuar dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomike për të vertetuar përmbushjen e këtyre kriterëve. Siellim në vendje përcaktimet e pikës 5, të nenit 77, të LPP, ku parashikohet se Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në fletën për shprehje interesi kriteret e për zgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomike për përmbushjen e këtyre kriterëve .

Pra AK ka detyrim ligjor që të përcaktojë se me çfarë dokumentash konkret përmbushen kërkesat e tij.

Kjo kerkese është evazive dhe krijon konfuzion tek OE të interesuar për të ofertuar në këtë procedurë prokurimi. AK, në hartimin e specifikimeve teknike, krahas përshkrimit të saktë të nevojave, duhet të kenë në vendje faktin, që specifikimet teknike, duhen bërë në mënyrë gjithëpërfshirëse, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanëshme e të hapur, ndërmjet të gjithë kandidatëve ofertues, duke përshkruar saktë dhe plotë karakteristikat e mallrave, në përputhje me objektin e kontratës. Neni 36, pika 1 dhe 3 LPP nr 162/2020, përcakton qartë se:

1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurorët.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

- a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;
- b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;
- c) kërkesave në terma funksionale sipas shkronjës "a", referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës "b" të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;
- ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".

Se dyti sa i perket shprehjes "origjinale":

Ky është një specifikim teknik kufizues dhe drejton OE drejt një prodhuesi të vetëm, që është ai që ka prodhuar paisjen. Ky specifikim kufizon konkurrencën dhe shkel parimet e trajtimit të barabartë, transparencës dhe diskriminimit të cilat i përcakton LPP 162/2020. Referuar LPP, rregullores të prokurimit publik dhe udhëzimeve të ndryshme të APP, krahas fjalës origjinale, AK duhet të shtojë dhe fjalën "ose ekuivalent"

Ju sjellim në vëmendje shtojcën 5 specifikimet teknike në DST, në të cilën përcaktohet:

"SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

"Në nenin 4 "Përkufizime" të ligjit Nr.162/2020 Për Prokurimin Publik parashikohet se:

"Ekuivalente është malli ose shërbimi i ofruar me karakteristika të barasvlefshme me ato që janë përcaktuar në specifikimin teknik të objektit të prokurimit."

Njoftimi Nr.8297/3, datë 23.01.2020 I APP, përcakton se:

Gjithashtu, në procedurat e prokurimit me objekt Blerje tonera, në të cilat autoritetet kontraktore kërkojnë që tonerat të jenë origjinale, duhet të përfshijë edhe fjalët "ose ekuivalent". Kërkesa për tonera origjinale pa përfshirë termin "ose ekuivalent", kon vetëm tek prodhuesit e pajisjeve. për të cilat kerkohen tonerat, duke shmangur prodhues të tjerë që ofrojnë tonera ekuivalente me originalet. Kjo me pas sjell si pasojë kufizim të pjesëmarrjes dhe konkurrencës në keto procedura prokurimi.

Në keto kushte, kërkojmë modifikimin e specifikimeve, duke përfshirë edhe termin "ose ekuivalent".

Sa me sipër ju sjellim në vëmendje qendrimin që mban KPP në raste të tilla, pasqyruar në Vendimin Nr. 125/2022:

"Ligjvënësi ka parashikuar qartësisht në nenin 36 pika 1 paragrafi 4 të ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", se duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe

ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. Në respekt të parimit të mësipërm, specifikimet teknike, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përjashtojnë nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit qofshin këta kombëtarë apo ndërkombëtarë. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, qoftë ato të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt. Në asnjë rast, specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/malli/shërbimi që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm. t; Në vendimin e GJED Çështja C-368/10 “Komisioni European vs. Mberëtëria e Hollandës” inter allia dhe mutatis mutandis është arsyetuar se: “Specifikimet teknike të hartuara nga blerësit publik duhet të lejojnë që prokurimet publike të hapen në konkurrencë. Për këtë qëllim, duhet të jetë e mundur të dorëzohen tenderë që pasqyrojnë larminë e zgjidhjeve teknike. Prandaj, duhet të jetë e mundur të hartohen specifikimet teknike për sa i përket performancës funksionale dhe kushteve, dhe, kur referimi bëhet në standardin Evropian ose, në mungesë të tij, ndaj standardit kombëtar, oferutesit bazuar në marrëveshje ekuivalente duhet të merren në konsideratë nga autoritetet kontraktuese.” III.2.5. KPP gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 germa “dh” se qëllimi i ligjit të prokurimit publik nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” si ligj material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjithë palët në proces. Sa më sipër, KPP gjykon se për autoritetin kontraktor e rëndësishme është që nëpërmjet specifikimeve teknike të përcaktuara, të lejohet pjesëmarrja e një numri të gjerë konkurrentësh me qëllim përfitim të një malli me performancë të lartë e me çmim të ulët. Sqarojmë se autoriteti kontraktor në asnjë moment nuk duhet të përcaktojë parametra teknikë kufizues e përjashtues, por duhet të përcaktojë parametra minimalë dhe me diapazon të gjerë duke përdorur një minimum dhe një maksimum të parametrave në mënyrë që të rritet konkurrenca ndërmjet operatorëve ekonomikë, me qëllim pjesëmarrjen e një numri sa më të lartë të operatorëve ekonomikë të interesuar. Në rastin konkret, referuar objektit të prokurimit, KPP gjykon se për autoritetin kontraktor, është e rëndësishme që të provohet se mallrat objekt-prokurimi, përmbushin kushtet funksionale.”

Vendimin Nr. 124/2022:

“III.2.8 KPP gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 germa “dh” se qëllimi i ligjit të prokurimit publik nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” si ligj material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjitha palët në proces. Referuar objektit dhe volumit të kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik, thekson se, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme që të krijojë bindjen se operatorët ekonomikë kanë aftësi të ofrojnë produktet objekt-prokurimi, të nevojshme për zbatimin me sukses të kontratës, por gjithmonë duke përcaktuar kritere në përputhje me objektin e kontratës, në përpjesëtim me volumin e saj, si dhe jo kufizuese apo diskriminuese. Komisioni gjykon, se është e nevojshme që operatorët ekonomikë të ofrojnë produktet objekt-prokurimi por jo domosdoshmërisht në mënyrë kufizuese, pasi në fushën e veprimtarisë objekt-prokurimi, ekzistojnë edhe artikuj të tjerë ekuivalent, të cilët kanë funksionalitet të njëjtë. Gjithashtu, Komisioni gjykon, se edhe kërkesa për disponimin e artikujve me këto specifikime është e ekzagjeruar. Autoriteti kontraktor në asnjë moment nuk duhet të përcaktojë specifikime teknike kufizuese e përjashtuese, me qëllim pjesëmarrjen e një numri sa më të lartë të operatorëve ekonomikë të interesuar, ndaj çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti tij/saj”.

Autoriteti Kontraktor është i detyruar të zbatohet me përpikëri dispozitën e mesipërme të LPP-së në hartimin e specifikimeve teknike dhe kjo duhet pasqyruar edhe në dokumentet e tenderit duke shtuar termin ekuivalent për zërat e sipërpermendur.”

2. 2. Në kriteret e veçanta në DST, AK ka kërkuar:

”Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë mostra për artikujt të cilët kanë përdorueshmëri më të lartë për institucionin, përkatesisht për zërat në preventiv me numër rendor 1,2,3,4,5,6,7,8,9,10,11,12,13,14,15,16,17,18,19,20,22,25 me qëllim verifikimin nëse këto produkte plotësojnë kërkesat dhe specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentat e tenderit. Dorëzimi i mostrave do të bëhet ditën e hapjes së procedurës. Mostrat duhet të jenë të mbyllura në një zarf/kuti jo transparente të vulosur dhe së bashku me mostrat, ofertuesi duhet të bëjë shoqërimin e mostrave me një shkresë të firmosur nga përfaqësuesi ligjor dhe vulosur ku të listohen mostrat që ndodhen në zarf/kuti. Mosparaqitja e të gjitha mostrave është kusht për skualifikim.”

Së pari vëmë re se AK ka kërkuar mostra për të gjithë artikujt tonera/bojra. Kjo kërkesë është e ekzagjeruar dhe në tejkalim të ligjit, pasi AK po kërkon mostra dhe për artikujt në sasi shumë të vogla.

Lidhur me paraqitjen e mostrave për çdo artikull, KPP është shprehur në vendimin K.P.P. 122/2020: “Kërkesa për dorëzimin e mostrave për secilin artikull, është një kërkesë e ekzagjeruar dhe shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme për realizimin e synimit. Komisioni gjykon se, është e mjaftueshme që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të paraqesin vetëm nga një ekzemplar (mostër) për produktet që do të prokurohen, më përdorueshmëri më të lartë për institucionin, me qëllim verifikimin nëse këto produkte plotësojnë kërkesat dhe specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentat e tenderit.”

Lutemi të modifikohet kërkesa për mostra pasi kërkesat duhet të jenë në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës, të kërkojnë mostra vetëm për artikujt bojra me përdorim me të madh. Duke kërkuar mostra për të gjithë artikujt bojra, edhe për ato që AK do të blejë në sasi fare të vogël, ngarkohen OE me shpenzime ekonomike të panevojshme, pasi detyrohen të blejnë të gjitha mostrat, që në momentin e ofertimit, pamvarësisht nëse do të jete fitues apo jo.

Kërkojmë që AK të modifikojë këto kriter duke kërkuar mostra për artikujt me sasi 15 cope e lart.

Së dyti, AK ka kërkuar mostra dhe për artikujt me logo, sic janë artikulli Nr.22 dhe artikulli Nr.25:

22 Letër A4 Letër A4 80 gr/m² paketuar me rizma 500 fletë. Bardhësia 100%(Ekuivalent Double A). 10% e letreve të jenë me logon e bashkisë me ngjyra .

25 Dosje Dosje të thjeshta(karton i fortë) me logon e Bashkisë Prrenjas. Të përmbajë cilësime të titullit dhe numrin e dosjes.

Kjo kërkesë, ka dy problematika:

Së pari, vetë AK nuk ka dhënë të dhënat e domosdoshme (logoja vektoriale) për të stampuar logon. OE, nuk ka asnjë mundësi të realizojë këto shërbime, pa këto informacione.

Së dyti, kërkesa për të dorëzuar mostra të loguara është e ekzagjeruar dhe sjell kosto të pajustificuara për OE si në kohë ashtu edhe në vlerë monetare. Ajo që është me rëndësi për AK

është që nepermjet mostrave të dorëzuara të arrijë të gjykojë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike që ai ka kërkuar dhe që cilësia e mallit të jetë në përputhje me kërkesat e tij. Në këto kushte kërkojmë heqjen e kërkesës për të dorëzuar mostra me logo.

Sa më sipër ju sjellim në vëmendje qëndrimin që mban KPP në rastet e tilla, pasqyruar në Vendimin Nr.882/2021:

“Në këto kushte, KPP gjykon se kërkesa e mësipërme e autoritetit kontraktor mbi dorëzimin e mostrave është në përputhje me nenin 40, pika 6 gërma “a” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, por kërkesa që për disa nga këto produkte mostrat të jenë të personalizuar me logon përkatëse sipas specifikimeve teknike, është një kërkesë e ekzagjeruar dhe shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme për realizimin e synimit. Vlen të theksojmë se, qëllimi i autoritetit kontraktor, është furnizimi në kohë dhe në cilësi me produktet objekt-prokurimi, por në respekt të parimeve të ligjit për prokurimin publik, kriteret e kualifikimit të hartuara nga autoriteti kontraktor, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë /përfshijnë nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit qofshin këta kombëtarë apo ndërkombëtarë. Në hartimin e kriterëve të kualifikimit autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, e cila kufizon pjesëmarrjen e gjerë të operatorëve ekonomikë në një procedurë prokurimi. Sa më sipër, Komisioni gjykon se, është e mjaftueshme që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të paraqesin mostra për produktet që do të prokurohen, por jo domosdoshmërisht këto mostra të jenë të loguara me logon e institucionit.”

Për artikullin Nr.49, në formularin e specifikimeve teknike “shtojca 5” keni kërkuar:

49 LapustilLapustilCopë 20

Ju lutemi saktësoni lapustilen e doni për table apo permanent(që nuk fshihet)?Apo kerkoni evidenciatore?

Për artikullin Nr.59, në formularin e specifikimeve teknike “shtojca 5” keni kërkuar:

59 CD CD-RW 700MB. Pako me 50 copë të pajisur me zarf
përkatës. Pako 2

Ju lutemi saktësoni, këtu artikull e kerkoni CD-R apo CD-RW ?

Për artikujt Nr.77-81, në formularin e specifikimeve teknike “shtojca 5” keni kërkuar:

77	Blllok tregu	Blllok tregu 50 lekë.	Copë	300
78	Blllok tregu	Blllok tregu 20 lekë.	Copë	100
79	Blllok tregu	Blllok tregu 30 lekë.	Copë	100
80	Blllok tregu	Blllok tregu 100 lekë.	Copë	100
81	Blllok tregu	Blllok tregu 200 lekë.	Copë	100

Ju lutemi precaktësoni permasat e bllokut dhe numrin e fleteve. Bllloku duhet të jetë me numër serial, apo pa numër serial?

Për artikullin Nr.22, në formularin e specifikimeve teknike “shtojca 5” keni kërkuar

22 Letër A4 Letër A4 80 gr/m2 paketuar me rizma 500 fletë. Bardhësia 100% (Ekuivalent Double A). 10% e letreave të jenë me logon e bashkisë me ngjyra .

Lutemi që kete artikull ta ndani ne dy zera, pasi letra me logo, patjeter ka kosto me te larte , rrjedhimisht edhe cmim me te larte. Nuk mund te plotesojme formularin e cmimit ne kete menyre

5. Kërkesë për ekspertizë të posaçme

Po

Jo

(Nëse po, specifikoni llojin e ekspertizës që kërkonte)

6. Kërkesë për përjashtim të zyrtarëve që do të merren me shqyrtimin e ankesës:

nuk ka

7. Lista e informacionit konfidencial:

nuk ka

Përcaktoni se cili informacion është konfidencial, nëse ka. Shpjegoni pse informacioni është ose një version i dokumenteve përkatëse me heqjen e pjesëve konfidenciale dhe një përmbledhje të përmbajtjes.

Kujdes: Ankimesi duhet t'i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës së prokurimit, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe kopjet shtesë, pranë **Autoritetit/Enti Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik**.

Shënim: Ankimuesi duhet ta dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit publik

Nr. i faksit:

E-mail:

aarapi@infosoftoffice.al

Nënshkrimi dhe vula e Ankuesit

Administratori/Përfaqësuesi i autorizuar

Frederik Prodani